

**VENDIM**  
**Nr. 817, datë 24.12.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 26, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË DHE ÇAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, shifra “... 914 561 348 (nëntëqind e katërbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 1 114 561 348 (një miliard e njëqind e katërbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH ...”.

b) Në shkronjën “a”, të pikës 2, shifra “... 445 562 231 (katërqind e dyzet e pesë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 645 562 231 (gjashtëqind e dyzet e pesë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH ...”.

2. Efektet financiare, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**